


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori IV, 2022

Tiranë, më 06 Mars 2023: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e katërt të vitit 2022, arriti 112,4 kundrejt vitit 2020. Krahasuar me tremujorin e katërt 2021, indeksi i çmimeve të importit shënoi një rritje me 6,7 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 4,9 %. Krahasuar me tremujorin e tretë 2022 indeksi shënoi rritje me 0,8 %.

Fig.1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Çmimet e importit të produkteve në seksionin “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” kanë shënuar rritje me 19,4 %. Indeksi në seksionin “Industri nxjerrëse” shënoi një rritje me 14,9 %, krahasuar me një vit më parë. Indeksi në seksionin “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 91,4 % shënoi një rritje me 5,9 %. Brenda këtij seksioni rritja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 13,4 %, pasuar nga “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 10,8 %, “Prodhimi i pijeve” me 10,0 %, “Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë” me 9,3 %, “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 9,0 %, “Metalurgjia” me 8,7 %, “Prodhimi i tekstileve” me 8,0 %, “Prodhimi i pajisjeve elektrike” dhe “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 7,9 % secila, “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” me 6,8 %, etj.

Për publikim 06/03/2023

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e tretë 2022, çmimet e importit të produkteve në seksionin “Industri nxjerrëse” dhe “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” kanë shënuar rritje me 2,9 % secili. Çmimet në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” u rritën me 1,1 %. Rritje shënoi edhe seksioni “Industria përpunuese” me 0,7 %. Brenda këtij seksioni rritja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike” me 3,0 %, pasuar nga “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 2,2 %, “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 1,8 %, etj.

Tab.1 Indeksi i Çmimeve të Importit

2020=100

NVE Rev.2	Përshkrimi	Peshat	10-22	11-22	12-22	IV-22
	Gjithsej	100,0	112,5	112,5	112,4	112,4
B	Industri Nxjerrëse	0,2	118,2	118,1	118,1	118,1
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	118,2	118,1	118,1	118,1
C	Industria Përpunuese	91,4	109,3	109,7	109,5	109,5
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,5	117,9	117,9	117,8	117,9
11	Prodhimi i pijeve	3,1	115,8	115,6	115,6	115,7
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	3,1	110,6	110,6	110,0	110,4
13	Përpunimi i tekstileve	3,2	109,3	109,6	109,5	109,5
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,8	105,7	106,5	106,8	106,3
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,2	108,8	108,8	108,7	108,7
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,5	106,2	106,4	106,0	106,2
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	2,1	106,7	106,8	106,6	106,7
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	112,8	112,8	113,0	112,9
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	7,2	110,1	112,5	111,5	111,3
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,8	107,9	108,2	107,8	108,0
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	10,8	104,6	104,6	104,6	104,6
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	3,9	104,3	104,5	104,5	104,4
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	2,9	112,6	112,7	112,7	112,7
24	Metalurgjia	5,6	114,6	114,8	114,5	114,7
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,7	105,3	106,5	105,3	105,7
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	5,2	109,7	109,5	110,1	109,7
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,9	110,9	111,0	110,6	110,8
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	4,8	103,9	103,9	104,3	104,0
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	108,9	109,7	111,3	110,0
31	Prodhimi i mobiljeve	0,7	103,6	103,6	103,5	103,5
32	Industri të tjera p,k,t	2,1	105,0	104,9	104,8	104,9
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	7,5	192,4	186,2	187,3	188,6
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	7,5	192,4	186,2	187,3	188,6
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	113,9	113,9	113,9	113,9
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	113,9	113,9	113,9	113,9

Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

në %

NVE	Përshkrimi	Peshat	IV- 22 /III- 22	IV- 22 / IV- 21
	Gjithsej	100,0	0,8	6,7
B	Industri Nxjerrëse	0,2	2,9	14,9
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo kamierat	0,2	2,9	14,9
C	Industria Përpunuese	91,4	0,7	5,9
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,5	0,6	13,4
11	Prodhimi i pijeve	3,1	0,1	10,0
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	3,1	2,2	7,9
13	Përpunimi i tekstileve	3,2	0,7	8,0
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,8	0,7	2,9
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,2	1,4	5,7
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,5	-0,9	1,9
17	Prodhimi i letres dhe produkteve prej letre	2,1	1,5	5,2
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	1,8	10,8
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	7,2	-1,6	4,1
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,8	0,5	4,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	10,8	3,0	-1,0
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	3,9	0,9	1,8
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	2,9	0,1	9,0
24	Metalurgjia	5,6	-0,9	8,7
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,7	0,8	4,1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	5,2	1,5	9,3
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,9	0,6	7,9
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	4,8	0,5	1,4
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	-3,2	6,8
31	Prodhimi i mobilie	0,7	-0,9	2,3
32	Industri të tjera p,k,t	2,1	0,1	4,7
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	7,5	2,9	19,4
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	7,5	2,9	19,4
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	1,1	8,8
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	1,1	8,8

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev,2) në nivel 2-shifror,

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar, Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori,

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe tremujorit të mëparshëm,